LIGJ
Nr. 148/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË SISTEMIT TË UJËRAVE TË ZEZA TË BILISHTIT, "KONTRATË ME ÇELËSA NË DORË – LOTI 1"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria, AG për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, "Kontratë me çelësa në dorë - Loti 1", me një hua të butë prej 2 998 856 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8795, datë 18.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI

Hua e Butë nr. 233.258
për një shumë maksimale prej 2, 998, 856.00 euro
datë .....korrik 2014
lidhur ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave (si "Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG (si "Huadhënës") në lidhje me financimin e "Projektit të Përfunduar të Sistemit të Ujërave të Zeza Bilisht – Loti 1".

Kjo marrëveshje kredie eksporti për një hua të butë nr. 233 258 për një shumë maksimale prej 2 998 856.00 euro ("Marrëveshja") është e datës ..... korrik 2014, e lidhur ndërmjet Huamarrësit të specifikuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi), të specifikuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIME

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme: -

"Datë e Pranimit" është data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja palët dhe ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

"Aneks" është një aneks në këtë Marrëveshje ku termat e këtij aneksi konsiderohen të jenë përfshirë në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

"Periudhë e Disponibilitetit" janë afatet e specifikuara në aneksin 3, Huamarrjet e të cilave mund të tërhiqen kundrejt Instrumentit të Kredisë.

"Huamarrje" është një shumë e tërhequr nga Huamarrësi kundrejt Instrumentit të Kredisë.

"Ditë Pune" është një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe veprime dhe depozita në këmbimin e huaj ndërmjet bankave që mund të kryhen në Vjenë dhe në Tiranë.

"Data e Mbylljes" është data e përkufizuar në seksionin 7.

"Instrument Kredie" është shuma e specifikuar në aneksin 3 kundrejt së cilës Huamarrësi mund të tërheqë Huamarrjet gjatë Periudhës së Disponibilitetit.

"Euro" ose "€", monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë euron si monedhë të tyre në pajtim me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Europian Ekonomik dhe Monetar.

"EURIBOR" është norma ndërbankare e ofruar nga Federata bankare e Bashkimit Europian (ose një person tjetër që merr përsipër administrimin e normës) të vendosur në faqen e EURIBOR-1 të Reuters Screen (ose çdo faqe zëvendësuese Reuters që tregon normën ose faqen përkatëse të një shërbimi informimi që publikon këtë normë herë pas here të Reuters-it, që përcaktohet nga Huamarrësi për ofrimin e depozitave në euro për një periudhë të krahasueshme me Periudhën e Interesit për Huan përkatëse në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në Ditën e dytë të Punës para fillimit të kësaj Periudhe Interesi dhe, nëse kjo normë është zero ose poshtë zeros, EURIBOR-i konsiderohet të jetë zero. Kjo normë përcaktohet mbi bazën e një viti me 360 ditë.

"Llogari Instrumenti" është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.3.

"Data e fundit e Pranimit" është data në të cilën Huadhënësi ka marrë nga Eksportuesi i Projektit kopjen e protokollit të fundit të pranimit të aprovuar nga Blerësi i Projektit.

"Datat e Pagesës së Interesit" është 31 marsi, 30 qershori, 30 shtatori dhe 31 dhjetori i çdo viti, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është Ditë Pune, referenca në këtë datë është në Ditën e Punës pararendëse.

"Periudhë Interesi" është një periudhë:

i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të Periudhës pararendëse të interesit; dhe

ii) që mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator, 31 dhjetor në çdo vit

"Barrë" është çdo hipotekë, rëndim, peng, barrë, hipotekim, mbajtje titulli ose një interes tjetër garancie të çdo lloji, pavarësisht nga mënyra e lindjes.

"Hua" do të thotë shuma e përgjithshme principale e Huamarrjeve të dhëna sipas Instrumentit të Kredisë dhe për kohën e mbetur.

"Datat e Shlyerjes së Detyrueshme" do të thotë datat në çdo vit, të specifikuara në aneksin 3, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është Ditë Pune, referenca në këtë datë është në Ditën e Punës pararendëse.

"OeKB" do të thotë Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, 1011 Vienna, Austria, që vepron si Agjenci Kredie Eksporti për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

"Garanci e OeKB-së" është një Garanci nr. 233 258 e lëshuar nga OeKB-ja në lidhje me instrumentin e Kredisë për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Ligjin e Promovimit të Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar.

"Procedurë Pagese" është procedura për page-sën e Huamarrjeve, të specifikuara në aneksin 4.

"Projekti" është Projekti i specifikuar në ane-ksin 2.

"Blerësi i Projektit" është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Tiranë, Republika e Shqipërisë,

e përcaktuar në aneksin 2.

"Eksportues Projekti" është STRABAG AG, Spittal a.d. Drau, Austria, i specifikuar në ane-ksin 2.

"Marrëveshje e Blerjes" është marrëveshja në lidhje me Projektin e lidhur ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe e specifikuar në aneksin 2.

"Seksion" do të thotë seksion i kësaj Marrëveshjeje.

2. INSTRUMENTI I KREDISË

2.1 Preambulë

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe kushteve sipas të cilave Huadhënësi do të financojë 100% të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në një shumë maksimale të specifikuar si "Instrumenti i Kredisë" në aneksin 3) që duhet të paguhet nga Blerësi i Projektit Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Instrumenti i Kredisë

Huadhënësi bie dakord t'i ofrojë Huamarrësit Instrumentin e Kredisë gjatë Periudhës së Disponibilitetit sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje mund të bëhet nga Huamarrësi sipas Instrumentit të Kredisë në pajtim me Procedurën e Pagesës së specifikuar në aneksin 4 dhe zbatohet kundrejt pagesës që i kërkohet Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

Kredia e dhënë jepet sipas dhe në bazë të dispozitave të rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi vëren që financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,30 % (tridhjetë e pesë pikë tridhjetë për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një Huamarrjeje nëse një Huamarrje e tillë dhe interesi i saj nuk do të mbulohej nga garancia e dhënë nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin e Promovimit të Eksportit, i ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e financimit me OeKB-në për Instrumentin e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e Instrumentit

Huadhënësi hap një llogari instrumenti në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si "Llogaria e Instrumentit". Çdo Huamarrje debitohet nga Llogaria e Instrumentit, në pajtim me këtë Marrëveshje, vlerën dhe datën e pagesës së kësaj Huamarrjeje. Shlyerjet dhe Parapagimet zbatohen përkatësisht në Llogarinë e Instrumentit.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe Marrëveshja e Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë mospërmbushje e detyrimeve të Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon mbi detyrimet e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit, dhe Huadhënësi nuk është përgjegjës për asnjë mosveprim të Eksportuesit të Projektit dhe/ose një pale tjetër në Marrëveshjen e Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi për Llogarinë e Instrumentit

Huamarrësi paguan interesin në Datat e Pagesës së Interesit me një normë të përcaktuar sipas specifikimit në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e kredisë së pashlyer.

3.2 Llogaritja dhe Data e Pagesës së Interesit

Interesi i kërkueshëm në pajtim me seksionin 3.1 mblidhet nga dita në ditë, llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një viti me 360 ditë, dhe, përveç kur parashikohet ndryshe në seksionin 6.1, i paguhet në fund të çdo semestri nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rastin e moskryerjes nga Huamarrësi të pagesave në datën e kërkueshme të një shume të kërkueshme, Huamarrësi paguan interes për këtë shumë nga data e moskryerjes deri në datën e pagesës faktike të normës së specifikuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas seksionit 3.3 është i kërkueshëm në Datat e Pagesës së Interesit.

4. TARIFA DHE SHPENZIME

4.1 Tarifa e Zotimit Financiar

Për periudhën që fillon në Datën e Mbylljes dhe që përfundon në fund të Periudhës së Disponibilitetit, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë në normën e specifikuar në aneksin 3. Tarifa e Zotimit Financiar e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1 llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve që kanë kaluar dhe një viti me 360 ditë nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të Instrumentit të Kredisë në fillimin e çdo semestri kalendarik dhe paguhet në fund të çdo periudhë nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit. Pagesa e parë e tarifës së zotimit financiar bëhet në Datën e parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Mbylljes.

4.2 Tarifa e Menaxhimit

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditëve Pune para disbursimit të parë të Instrumentit të Kredisë) i paguan Huadhënësit tarifën e Menaxhimit të specifikuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Për më tepër, Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (duke përfshirë shpenzimet juridike, të përkthimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet në lidhje me garancinë e OeKB-së) të shkaktuara nga Huadhënësi në rastin e paditjes ose kompensimit të shumës së kërkueshme nga Huadhënësi.

ii) Të gjitha taksat, detyrimet shpenzimet dhe detyrime të tjera që i ngarkohen Huadhënësit nga Ministria e Financave të Shqipërisë ose një autoritet tjetër shqiptar në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara në të janë në llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi Huadhënësit.

4.4 Primi i Garancisë së OeKB-së

Sipas Marrëveshjes Huadhënësi i ngarkon Huamarrësit një kompensim për primin e garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i Garancisë së OeKB-së dhe Tarifa e Trajtimit të OeKB-së së pagueshme në fillim

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditëve Pune para disbursimit të parë të Instrumentit të Kredisë) i paguan Huadhënësit qysh në fillim pjesën e kompensimit të primit të garancisë të OeKB-së dhe tarifën e Menaxhimit të specifikuar në aneksin 3 në shumat e specifikuara në aneksin 3.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së e pagueshme si Marzh

Duke filluar me Datën e Pagesës së Interesit që bie pas Datës së Mbylljes, Huamarrësi i paguan Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë të OeKB-së të pagueshme si marzh sipas specifikimit në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në çdo semestër në Datat e Pagesës së Interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhet sipas seksionit 4.4 përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi informon Huamarrësin për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës përkatësisht dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit primi i garancisë së OeKB-së rritet, për shkak se: i) vlerësimi i riskut tregtar të bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet thelbësore në termat kontraktualë të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit janë miratuar, Huamarrësi rimburson Huadhënësin me kërkesë për këtë rritje.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e Detyrueshme

Huaja e mbetur në fund të Periudhës së Disponibilitetit shlyhet nga Huamarrësi në këtë numër të kësteve të barabarta gjysmëvjetore të shlyerjes në Datat e Shlyerjes së Detyrueshme të specifikuara në aneksin 3. Huamarrësi, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas Datës së Pranimit Provizor i njofton Huamarrësit listën e Datave të Shlyerjes së Detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në çdo datë të tillë.

5.2 Shlyerja Opsionale

Huamarrësi mund të shlyejë të gjithë ose një pjesë (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose në pjesë përbërëse të saj) të Huas pas një njoftimi me shkrim prej të paktën tridhjetë (30) ditësh (ky njoftim është i pakthyeshëm) për datën e propozuar të parapagimit drejtuar Huadhënësit duke iu nënshtruar aprovimit të OeKB-së dhe pagesës së shpenzimeve shtesë të bëra nga Huadhënësi. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet gjatë Periudhës së Disponibilitetit, e zvogëlon shumën e Instrumentit të Kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagesë. Çdo referencë tek Instrumenti i Kredisë në këtë Marrëveshje konsiderohet të jenë referenca në shumat e zvogëluara dhe të specifikuara në aneksin 3. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet pas skadimit të Periudhës së Disponibilitetit, zbatohet për të zvogëluar me shuma të barabarta kështet e shlyerjes së mëvonshme.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i Pagesës

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para çdo Date të Pagesës së Interesit, sipas rastit, Datës së Shlyerjes së Detyrueshme, Huadhënësi njofton Huamarrësin për këto shuma që janë të kërkueshme për t'iu paguar nga Huamarrësi Huadhënësit në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e zotimit financiar, me kusht që moskryerja e njoftimit si më sipër nuk e liron Huamarrësin nga detyrimi i tij për të bërë pagesat e këtyre shumave të mësipërme kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi specifikon, gjithashtu, për çdo pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (përvetësimin e shumave të kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e kështilluar dhe konfirmon zbatimin e fondeve me shkrim. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (përvetësimi i fondeve) për çdo shumë që i paguhet Huadhënësit. Nëse nuk merret ndonjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6.

Nëse një shumë e caktuar debitohet dhe/ose kreditoret në Llogarinë e Instrumentit dhe/ose një llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike para Datës së Pagesës së Interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me të në Datën e Pagesës së Interesit mbartet dhe bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme Huadhënësit në Datën pasuese të Pagesës së Interesit, përkatësisht rillogaritet (në rastin e shumave të krediturara) për Datën pasuese të Pagesës së Interesit.

6.2 Mënyra e Pagesës

Në çdo Datë të Pagesës së Interesit, Datë të Shlyerjes së Detyrueshme ose datë tjetër të kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi kryen pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, në vlerën dhe datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat nga Huamarrësi drejtuar Huadhënësit të shumave të kërkueshme bëhen në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme në Vjenë.

6.3 Heqja Dorë nga Kompensimi ose Kundërpretendimi

Huamarrësi heq dorë nga të gjitha të drejtat e kompensimit ose kundër-pretendimit që mund të ketë në lidhje me një shumë të kërkueshme nga Huadhënësi dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesa për asnjë arsye të shumave të kërkueshme për pagesë. Veçanërisht Huamarrësi nuk mban pagesën e shumave të kërkueshme nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje për shkak se ai ka pretendime, të drejtë padie, të drejta ose kërkesa kundrejt Eksportuesit të Projektit ose furnitorëve të

tjerë në lidhje me Projektin.

6.4 Pagesat e lira nga Mbajtja e Taksave dhe Detyrimeve të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje kryhen pa kompensim ose kundërpretendim dhe të lira dhe pa zbritje për ose për llogari të ndonjë tatimi, detyrimi, zbritjeje, mbajtjeje apo detyrimi tjetër të tashëm ose të ardhshëm të çdo natyre të Republikës së Shqipërisë, përveç kur Huamarrësit i kërkohet të bëjë këto zbritje me ligj. Nëse kjo i kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë rritet në masën e nevojshme për të siguruar që pas bërjes së kësaj zbritjeje të tatimeve, detyrimeve, zbritjeve, mbajtjeve ose detyrimeve të tjera huadhënësi merr në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse nuk do të duhej të bëhej kjo zbritje e tatimeve, detyrimeve, zbritjeve, mbajtjeve së detyrimeve të tjera. Huamarrësi i jep menjëherë Huadhënësit çdo faturë, certifikatë ose provë tjetër që provon shumat (sipas rastit) e paguara ose të pagueshme në lidhje me një zbritje apo mbajtje si më sipër.

6.5 Shpenzimet e shtuara

Nëse rezultati i:

- një ndryshimi në, ose prezantimi të një ligji, rregulloreje, kërkese rregullatore ose një ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

- përmbushjes nga Huadhënësi të një udhëzimi apo kërkese (pavarësisht nëse ka fuqinë e ligjit apo jo) të një banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose tjetër;

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, sendet pasurore rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) rrit shpenzimet ose ngarkon shpenzime shtesë për Huadhënësin në marrjen përsipër ose mbajtjen e detyrimit apo financimin e huas; dhe/ose

b) ul shumën e pagueshme ose kthimin faktik te Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) ul normën e Huadhënësit të kthimit në kapitalin e përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet të alokojë burimet kapitale sipas detyrimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) i kërkon Huadhënësit të bëjë një pagesë ose të heqë dorë nga një kthim, ose llogaritet me referencë te një shumë e arkëtuar ose e arkëtueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi i paguan Huadhënësit me kërkesë çdo shpenzim, zbritje, pagesë ose kthim të pakryer.

Çdo certifikatë e Huadhënësit në lidhje me këto shpenzime, zbritje, pagesë, heqje dorë nga kthimi, në mungesë të gabimeve të dukshme, është përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllimet e kësaj dispozite, Huadhënësi mund të alokojë ose të shpërndajë shpenzimet dhe/ose humbjet në mirëbesim te sendet e tij pasurore dhe detyrimet e tij (ose një kategori të tyre) mbi atë bazë që e konsideron të përshtatshme.

6.6 Caktimi i Pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit (përveç kur Huadhënësi ndryshon rendin e zbatimit) zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të kryer nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 dhe 4.3 (Tarifa e Menaxhimit dhe Shpenzimet);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.4 (Primi i Garancisë së OeKB-së);

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (Tarifa e Përkushtimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (Kamatëvonesa);

e) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);

f) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);

h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (Parapagesa Opsionale).

Huadhënësi vë në dijeni Huamarrësin në lidhje me çdo aplikim të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën dhënë Huamarrësit nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që në bazë të garancisë së OeKB-së, OeKB-ja ka rezervuar kundrejt Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar përvetësimin e pagesave të caktuara më sipër. Në një rast të tillë, Huadhënësi informon menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi pranon caktimin nga OeKB-ja dhe merr përsipër të shlyeja Huan dhe çdo shumë tjetër të mbetur sipas kësaj Marrëveshjeje që njoftohet (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme të saj) nga Huadhënësi Huamarrësit.

7. PARAKUSHTE

Ky Instrument Kredie bëhet i disponueshëm për Huamarrësin në datën (Data e Mbylljes) kur Huamarrësi merr një njoftim nga Huadhënësi që janë përmbushur ose është hequr dorë nga kushtet e mëposhtme në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi duhet të këtë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Huadhënësin së bashku me një certifikatë nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike para Datës së Mbylljes, me efektin që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi të plotë (aneksi 6);

b) një mendim nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë i pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që Huadhënësi mund të kërkojë (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të certifikuara të çdo pëlqimi ose autorizimi të përmendur në këtë mendim;

c) një kopje të një vendimi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që aprovon këtë Marrëveshje në parim;

d) një prokurë e lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të specifikuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjerë që duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht nga një person ose disa persona të autorizuar me prokurën e përmendur në paragrafin (d) më sipër;

f) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që i jepen Huadhënësit në emër të Huamarrësit;

g) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjitha dokumentet dhe njoftimet që i jepen Huadhënësit në emër të Blerësit të Projektit;

h) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë të gjithë dokumentet dhe njoftimet që i jepen Huadhënësit në emër të "Kontraktuesit" dhe "Palës së Tretë" që përkufizohet në nënklauzolën 1.1.2.4 të Marrëveshjes së Blerjes;

i) një emërim të një Përfaqësuesi për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

i) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që mund të kërkojë Huadhënësi për t'i dhënë kësaj Marrëveshjeje dhe transaksioneve të parashikuar në të një fuqi ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme.

ii) Huadhënësi duhet të këtë marrë:

a) një garanci të lëshuar nga OeKB-ja për dhe ne emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin e Nxitjes së Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e së cilës mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për Huan;

c) një marrëveshje shtesë me Eksportuesin e Projektit dhe aprovimin e autoriteteve të Huadhënësit të kësaj Marrëveshjeje.

iii) Çdo kusht shtesë (sipas rastit) të kërkuar në garancia e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të mësipërme, Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk janë përmbushur ose hequr dorë brenda Periudhës së Mbylljes së specifikuar në aneksin 3, kjo Marrëveshje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, pushon së qeni detyruese për palët.

Secili nga dokumentet dhe njoftimet e përmendura më sipër është në anglisht ose gjermanisht. Nëse nuk është në anglisht ose gjermanisht, këtij dokumenti i bashkëngjitet një përkthim i certifikuar në anglisht.

Kushtet në këtë seksion 7 (Parakushtet) përfshihen vetëm në përfitim të Huadhënësit dhe prej tyre mund të hiqet dorë ose të shtyhen nga Huadhënësi plotësisht ose pjesërisht me ose pa kushte.

8. NGJARJE TË QENIES NË VONESË

8.1 Ngjarje të Qenies në Vonesë

Secila nga ngjarjet e mëposhtme përbëjnë një Ngjarje të Qenies në Vonesë:

a) ka mospagesë për më shumë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga Huamarrësi për principalin, interesin ose shuma të tjera të kërkueshme në lidhje me Huan; ose

b) Huamarrësi nuk përmbush ose nuk respekton ndonjë kusht ose detyrim që gjendet në këtë Marrëveshje të ndryshëm nga pagesa e principalit, interesit ose një shumë tjetër për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data më e hershme kur Huamarrësi është vënë në dijeni për moskryerjen dhe data në të cilën Huamarrësit i është dhënë njoftim me shkrim për këtë moskryerje duke iu kërkuar të bëjë ndreqjen nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose angazhim i bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje rezulton se nuk është e vërtetë në një aspekt të rëndësishëm kur është bërë; ose

d) Huamarrësi është në vonesë të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me fondet e tërhequra të ndryshme nga Huaja (duke përfshirë në çdo rast detyrimin sipas një garancie); ose

e) një licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar ose tjetër) që kërkohet për vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huan, ose përmbushja e tyre revokohet ose pushon së qeni në fuqi për një arsye të caktuar; ose

f) Republika e Shqipërisë deklaron një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e saj për pagesë kundrejt kreditorëve; ose

g) çdo ngjarje që normalisht, sipas mendimit të Huadhënësit ka ndikim të konsiderueshëm negativ në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB-ja ose një prej dispozitave të saj revokohet, shfuqizohet ose pushon së qeni në fuqi ose pushon të japë garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme për një arsye, ngjarje ose rrethanë të caktuar që mund t'i atribuohet sferës së Huamarrësit.

8.2 Veprimi në rastin e Ngjarjes së Qenies në Vonesë

Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Qenies në vonesë dhe kjo vazhdon të ekzistojë, nga Huadhënësi mund të ndërmerret një ose të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) Huadhënësi, me njoftim me shkrim drejtuar Huamarrësit, e deklaron principalin dhe interesin e mbledhur në lidhje me Huan dhe të gjitha shumat e pagueshme menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, dhe pas kësaj këto bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pa parashtrime, kërkesa, kundërshtime apo një njoftim tjetër të këtij lloji;

b) Huadhënësi, me njoftim me shkrim drejtuar Huamarrësit, e deklaron Instrumentin e Kredisë të shfuqizuar, dhe pas kësaj detyrimi i Huadhënësit për të dhënë dhe vazhduar Huan shfuqizohet menjëherë; dhe

c) ato veprime të tjera që Huadhënësi mund të vendosë të marrë në diskrecionin absolut të tij.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, me kërkesë, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi pëson si pasojë e një qenieje në vonesë (duke përfshirë, por

pa u kufizuar tek interesi i paguar nga Huadhënësi huadhënësve të fondeve të marra prej tij për të mbuluar një shumë në vonesë). Një certifikatë nga një nëpunës rregullisht i autorizuar i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimeve të arsyeshme dhe detyrimeve dhe bazën e llogaritjes së tyre kur i paraqitet Huamarrësit (përveç gabimeve të dukshme) është provë përfundimtare për shumën e kësaj humbjeje, shpenzimi dhe detyrimi, me kusht që kjo certifikatë të jetë mbështetur nga dokumente që japin prova se këto humbje, shpenzime dhe detyrime mbështeten nga dokumente të përshtatshme.

Huamarrësi, menjëherë sapo të vijë në dijeni, i bën njoftim me shkrim Huadhënësit, për:

a) një Ngjarje të Qenies në Vonesë; ose

b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që me bërjen e njoftimit ose kalimin e një afati ose të dyja apo përmbushja e një kushti mund të çojë ose përbëjë Ngjarje të Qenies në Vonesë.

9. GARANCI DHE ANGAZHIME

9.1 Garancitë

Me qëllim për të shtyrë Huadhënësin të lidhë këtë Marrëveshje dhe të japë dhe të vazhdojë Huan e parashikuar në të, Huamarrësi në Datën e Pranimit jep garancitë e mëposhtme:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë pa kufizim dhe pa kusht detyrime të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të vet në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në vonesë për një detyrim pagesë dhe nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon ndonjë Ngjarje e Qenies në Vonesë;

c) Huamarrësi ka tagrin të lidhë këtë Marrëveshje dhe të marrë hua dhe të nënshkruajë, të shpallë dhe të përmbushë këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar termat dhe kushtet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të autorizojë ekzekutimin, shpalljen dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin të ekzekutueshëm në pajtim me termat e saj;

d) ekzekutimi, shpallja dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk shkel asnjë dispozitë të ligjit ose rregullores ekzistuese të Huamarrësit ose një marrëveshje, kontratë apo detyrim tjetër ku Huamarrësi është palë, ose që është detyruese për të ose sendet pasurore të tij;

e) të gjitha licencat, pëlqimet, regjistrimet ose aprovimet (qeveritare ose të tjera) të nevojshme në lidhje me ekzekutimin, shpalljen, përmbushjen, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose janë realizuar dhe janë në fuqi të plotë.

Garancitë e përcaktuara më sipër mbeten në fuqi pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe konsiderohen të përsëriten në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi merr përsipër dhe angazhohet para Huadhënësit si më poshtë:

a) Regjistrat:

Huamarrësi realizon:

1. që: i) Blerësi i Projektit mban regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja; ii) Blerësi i Projektit deklaron përdorimin e tyre në Projekt; dhe iii) Blerësi i Projektit regjistron përparimin e Projektit, duke përfshirë shpenzimet e tij;

2. Përfaqësuesit e Huadhënësit lejohen të inspektojnë Projektin, ndërmarrjen e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e sjella në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës;

a) t'i jepet ose t'i japë vetë Huadhënësit të gjithë informacionin që Huadhënësi mund të kërkojë në lidhje me shpenzimet e Huas, Projektit, Procesin e Vlerësimit dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna

në pajtim me Marrëveshjen e Blerjes.

b) *Pari Passu* dhe Pengu Negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje janë të paktën *pari passu* dhe të barabarta me të gjitha detyrimet e tjera të mbetura, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga Data e Pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e Huas mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk krijon apo bie dakord të krijojë një hipotekë, barrë, peng, rëndim apo garanci tjetër në tërësi ose pjesërisht mbi sendet e tij pasurore për të garantuar një detyrim ose për të siguruar një garanci të një detyrimi, përveç kur Huaja është e garantuar në mënyrë të barabartë ose e krahasueshme sipas bindjes së Huadhënësit.

c) Ndryshimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk bën, lejon apo bie dakord për një amendim, ndryshim, modifikim apo përfundim të Marrëveshjes së Blerjes pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMA-RRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë përfundimin, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrazhit të zbatueshme në atë kohë të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris nga tre arbitra.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që përdoret në gjykimin në arbitrazh është anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton detyrimin e palëve në lidhje me shpenzimet shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat bëjnë çdo përpjekje të zhvillojnë gjykimin dhe të përgatisin vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë vendimin ligjërisht të zbatueshëm.

f) Vendimi për vendimin e arbitrazhit regjistrohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose mund të bëhet kërkesë te një gjykatë e tillë për pranim gjyqësor të vendimit dhe për një urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi ndërmerr veprim gjyqësor (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestron, ekzekutimin ose një masë tjetër ekzekutive ose konservuese) ndaj Huamarrësit në lidhje me një çështje që rrjedh nga kjo Marrëveshje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Si përjashtim, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) "ambientet e misionit" të tashme ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, "ambientet konsullore" të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) një pasuri e patundshme që përfshihet në sferën e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 "Mbi pasuritë e patundshme shtetërore";

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë, të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që caktohet për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas ligjit ndërkombëtar publik.

h) Huamarrësi e cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si përfaqësues në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera kanë efekt, në rastin e njoftimit me shkrim me letër të regjistruar në momentin e marrjes, ose në rastin e njoftimit me faks, kur merret nga pala e cila në bazë të kësaj Marrëveshjeje lejohet ose i kërkohet të marrë një njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që ndonjë prej tyre mund t'i ketë specifikuar tjetrës me shkrim

në pajtim me seksionin 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqja Dorë, Mjetet Mbrojtëse Kumu-lative

Asnjë moskryerje ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence apo privilegji dhe asnjë ndërveprim ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk ka efektin e heqjes dorë; apo asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji nuk përjashton ushtrimin tjetër ose të mëtejshëm apo shtrimin e një të drejte, kompetence apo privilegji. Të drejtat dhe mjetet e mbrojtjes janë kumulative dhe nuk përjashtojnë asnjë të drejtë ose mjet mbrojtjeje që përndryshe do të kishte Huadhënësi. Asnjë njoftim apo kërkesë për Huamarrësin në çdo rast nuk i jep të drejtë Huamarrësit për një njoftim ose kërkesë tjetër apo njoftim në lidhje me të njëjtat rrethana dhe nuk përbën heqjen dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje gjykohet nga një gjykatë organ tjetër kompetent të jetë e paekzekutueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe ekzekutueshmëria e dispozitave të tjera nuk ndikohen apo cenohen në asnjë mënyrë nga kjo dhe palët bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të rishikuar dispozitën e pavlefshme për ta bërë atë të ekzekutueshme në pajtim me synimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të kalojë ose transferojë të gjithë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse subjekti që i transferohen është OeKB-ja ose (vetëm në rastin e Ngjarjes së Qenies në Vonesë) një banke tjetër apo instituti financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, te një subjekt tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi ka të drejtë t'u paraqesë në një mënyrë që është e zakonshme për bankat të gjithë informacionin që merr në lidhje me këtë marrëveshje ose marrëdhënien e biznesit me Huamarrësin - veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve - bankave, institucioneve të përbashkëta të bankave ose organizatave të preferuara për mbrojtjen e kreditorëve.

Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi ka të drejtë t'u japë informacion që rrjedh nga kjo Marrëveshje ose marrëdhënia e biznesit e Huadhënësit me Huamarrësin personave ose shoqërive të mëposhtme:

a) një anëtari të grupit të shoqërive të Huadhënësit;

b) një subjekti të mundshëm që i transferohen të drejtat ose një personi apo shoqërie që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;

c) OeKB-së dhe Republikës së Austrisë; dhe

d) një personi, autoriteti ose subjekti tjetër të cilit Huadhënësi duhet t'i tregojë çdo informacion të tillë në pajtim me një ligj ose urdhër gjykate apo organ tjetër apo organ rregullator udhëzimet e të cilit duhet të përmbushë Huadhënësi.

11.7 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet ose të ndryshohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të rregullt të palëve dhe ratifikimit nga Parlamenti i

Republikës së Shqipërisë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare shqiptare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më sipër në dy origjinale në gjuhën angleze dhe versioni në anglisht është detyrues dhe ka përparësi ndaj çdo përkthimi.

_____

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

_____

UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës

ANEKSI 1

PALËT

Huamarrësi
Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit, nr. 1
Tirana / Shqipëri
Faks: (355 4) 222 84 05
Tel. (355 4) 222 84 94
Në vëmendje të: Ministri i Financave

Huadhënësi
Emri: UniCredit Bank Austria AG
Adresa: Schottengasse 6-8, 1010 Vienna
Tel. +43 (0)5 05 05-56914
Faks: +43 (0)5 05 05-50318
Departamenti përgjegjës 8243 Structured Trade & Export Finance
Në vëmendje të: Znj. Theresia Weymiers
Znj. Bettina Witzmann

ANEKSI 2

1. Projekti:
"Projekti i Përfunduar i Sistemit të Ujërave të Zeza Bilisht – Loti 1"
2. Marrëveshja e Blerjes:

Është marrëveshja nr. 1562, datë 30 qershor 2014, në shumën prej 2 998 856.00 eurosh, ndërmjet Eksportuesit të Projektit STRABAG AG, Spittal a. d. Drau, dhe Blerësit të Projektit Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë, Tirane, në shumën prej 2 998 856.00 euro në lidhje me Projektin.

3. Blerësi i Projektit:

Është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Ujit dhe Kanalizimeve, Tiranë, Shqipëri.

4. Eksportuesi i Projektit:

Është STRABAG AG, Spittal a. d. Drau, Austri.

ANEKSI 3

1. Instrumenti i Kredisë (seksioni 2.2).

Një shumë që nuk kalon 2 998 856.00,00 euro (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë)

2. Periudha e Disponibilitetit (seksioni 2.2)

Nga Data e Mbylljes (sipas përcaktimit në seksionin 7) deri në datën që bie 18 muaj pas Datës së Mbylljes, që përfundon jo më vonë se 30 qershor 2016.

3. Interesi (seksioni 3.1)

0.00 në vit (zero për qind në vit)

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% në vit.

5. Tarifa e Përkushtimit (seksioni 4.1)

0,5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e Menaxhimit (seksioni 4.2)

0,5 % (zero pikë pesë për qind) e njësuar e Instrumentit të Kredisë

7. Primi i Garancisë (seksioni 4.4)

i) Primi i Garancisë e OeKB-së që paguhet në fillim

EURO 11,245.71 (vetëm treguese)

Shuma përfundimtare përcaktohet nga OeKB-ja me lëshimin e garancisë fillestare. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi paguan diferencën (sipas rastit) brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për këtë nga Huadhënësi.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së e pagueshme si Marzh

1.00 në vit (për qind në vit – vetëm tregues)

Sipas OeKB-së, norma e mësipërme mbështetet nga Ministria Federale Austriake e Financave nëpërmjet një ulje motivuese për një politikë zhvillimi që është afërsisht 217,420.00 euro. Norma përfundimtare dhe ulja përcaktohen nga OeKB-ja me lëshimin e garancisë fillestare të OeKB-së.

8. Tarifa e Trajtimit e OeKB-së

1.440.00 euro në lidhje me Sigurimin e Kredisë së Eksportit.

9. Datat e Shlyerjes së Detyrueshme (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të bëhet deri në 19 këste të barabarta të njëpasnjëshme gjysmëvjetore, i pari është i kërkueshëm 72 muaj pas Datës së Pranimit Përfundimtar (nëse kjo datë është më parë) jo më vonë se 90 muaj pas Datës së Mbylljes, në çdo rast kësti i parë i pagesës bëhet i kërkueshëm jo më vonë se 30 qershor 2022.

10. Shuma e Parapagesës Opsionale (seksioni 5.2)

EURO 500,000.00

11. Periudha e Mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në Datën e Pranimit dhe jo më vonë se deri gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas Datës së Pranimit.

ANEKSI 4
PROCEDURA E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin të paguajë në mënyrë të pakthyeshme Eksportuesit të Projektit deri në një maksimum total të shumës së Instrumentit të Kredisë i përmendur në aneksin 3, që është 2 998 856.00 euro, kundrejt prezantimit të dokumenteve të mëposhtme në pikat e Huadhënësit:

Parapagesa:

20% (njëzet për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 599 771.20 euro (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro pikë njëzet cent) janë të pagueshme si parapagesë, në vend pas paraqitjes së:

- faturës nr. 0 që përcaktohet në Marrëveshjen e Blerjes në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;
- kopje të Garancisë së Parapagimit e lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 20% të Marrëveshjes së Blerjes.

Pagesa për shërbimet dhe punët

70% (shtatëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 2,099,199.20 (euro dy milionë e nëntëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë/20) paguhen si parapagim për paketat përkatëse të punës pas paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

Faturat (nr. 1-32) sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Secila faturë tregon:

- emrin (përshkrimin) e paketës përkatëse;
- datën;
- vlerën e paketës përkatëse në total;
- shumën që duhet të paguhet (për Eksportuesin e Projektit);
- nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

Pagesa kundrejt certifikatës së marrjes në dorëzim:

10% (dhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është EUR 299,885.60 (euro dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetë qind tetëdhjetë e pesë /60) janë të pagueshme pas paraqitjes së:

- faturës nr. 33, lejimi i pranimit të përkohshëm sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;
- faturës nr. 34 të pranimit përfundimtar, sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet në çdo dokument që besohet prej tyre që është i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk merr përgjegjësi apo detyrim për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të një dokumenti(eve), ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuar në dokument(e) ose të vendosura në to; ai nuk merr përgjegjësi ose detyrim as për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga një dokument(e) apo për mirëbesimin e veprimeve dhe/ose mosveprimeve, paaftësinë paguese, përmbushjen ose gjendjen nga dërguesit, transportuesit, paraqitësit, marrësit ose siguruesit e mallrave dhe asnjë person tjetër të tillë.

Dërgimet e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve lejohet.

Huadhënësi i jep Huamarrësit një njoftim me shkrim pasi t'i jetë kryer një Huamarrje Eksportuesit të Projektit.

Pas kryerjes së një Huamarrjeje për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi i dërgon dokumentet përkatëse Huadhënësit me shërbim të veçantë korrieri.

ANEKSI 5
OPINIONI LIGJOR
(Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë:
Drejtuar: UniCredit Bank Austria AG

Datë .....

Unë, ..., duke vepruar në zotësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233. 258 për një shumë prej 2 998 856.00 eurosh ("Marrëveshja") datë ..... korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës). Unë nuk shpreh asnjë mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni përveç se të Republikës së Shqipërisë.

Unë kam shqyrtuar një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes dhe ato dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të duhura për t'i shqyrtuar me qëllim që të japë këtë mendim. Termat e përkufizuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur përcaktohen ndryshe.

Bazuar sa më sipër, unë jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë pa kufizim dhe pa kusht detyrime të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të vet në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të detyrojë ligjërisht Huamarrësin. Për pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka zotësinë të paditë dhe të paditet në emrin e vet.

c) Huamarrësi ka kompetencën të lidhë dhe të përmbushë këtë Marrëveshje. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas termave dhe kushteve të parashikuara në të dhe vënien në ekzekutim, shpalljen dhe përmbushjen e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. ..... në cilësinë e tij si Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përmban detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të ekzekutueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në pajtim me termat e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë ose të certifikojnë një dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen kanë të gjitha kompetencat dhe autorizimet e nevojshme për ta bërë këtë në emër të Huamarrësit.

g) Nënshkrimi dhe përmbushja e Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuar në të nuk bien në kundërshtim me: i) asnjë ligj, rregullore apo vendim zyrtar apo gjyqësor; ii) asnjë traktat, marrëveshje ose dokument apo instrument tjetër ku Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që është detyrues për të ose ndonjë prej sendeve të tij pasurore.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (duke përfshirë, sipas rastit, aprovimet e kontrollit të këmbimit), pëlqimet, licencat, përjashtimet, depozitimet, regjistrimet, noterizimet dhe çdo kërkesë tjetër të institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike dhe autoriteteve të nevojshme dhe të këshillueshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, vlefshmërinë dhe përmbushjen e Marrëveshjes dhe çdo pagesë që

bëhet sipas saj, janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi të plotë dhe Huamarrësi ka autoritetin e plotë të kryejë të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në EURO (euro).

i) Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të bëhen të lira dhe pa zbritje për llogari të tatimeve, detyrimeve, zbritjeve ose barrëve të tjera nga Republika e Shqipërisë, një nënndarje politike apo autoriteti tatimor. Në rastin e një ndalimi në lidhje me pagesat e interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shuma të tjerë shtesë në pajtim me seksionin 6.4 është i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm.

j) Kjo Marrëveshje ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare shqiptare, dhe nuk është e nevojshme ose e kështillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria me prova e Marrëveshjes nëpërmjet depozitimit, regjistrimit te ndonjë autoritet apo agjenci tjetër qeveritare në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e Ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe ekzekutohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10. (g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t'i mundësohet Huadhënësit të ekzekutojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet ose të ketë të drejtën të zhvillojë biznes në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi nuk është as rezident, me vendbanim dhe nuk zhvillon biznes dhe nuk i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshëm dhe detyrues sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtarë dhe i ekzekutojnë këto vendime dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas njohurive të mia më të mira, asnjë gjykim, procedurë arbitrazhi apo procedurë administrative nuk zhvillohen apo janë në gjykim e sipër dhe, sipas njohurive tona, të mundshme ndaj Huamarrësit që mund të kenë si rezultat një ndryshim negativ të konsiderueshëm në gjendjen financiare të Huamarrësit.

n) Marrëveshjet dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë asnjë dispozitë që konsiderohet e paekzekutueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrë-veshjes gjithmonë renditen të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të huamarrësit, përveç atyre detyrimeve që preferohen detyrimisht nga ligji.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t'u deklarohet personave të tjerë.

Me respekt

ANEKSI 6
KONFIRMIM QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI TË PLOTË

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233 258 për një shumë prej

2,998,856.00 euro (Marrëveshja) datë ..... korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës).

Të nderuar zotërinj,

Ne konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes nr. 1562 e lidhur më 3 qershor 2014 ndërmjet STRABAG AG, Spittal a.d. Drau dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë ka hyrë në fuqi më (.....).

Spittal a.d. Drau, ...

.....

STRABAG AG

ANEKSI 7

PRANIMI I EMËRIMIT TË PËRFAQËSUESIT

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 233. 258 për një shumë prej 2, 998, 856.00 eurosh ("Marrëveshja") datë ..... korrik 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi ("Huadhënës").

Të nderuar Zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, në pranoj, emërimin e ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për të shërbimet si Përfaqësues dhe në lidhje me këtë Marrëveshje.

Adresa e Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, është: .....

Nëse do të ketë ndryshime në adresën time, unë do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

.....

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri

vendi, data .....